



## MISIONI NDËRKOMBËTAR PËR VËZHIMIN E ZGJEDHJEVE (MNVZ)

**Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë  
Zgjedhjet presidenciale, 13 prill 2014**

---

### DEKLARATA E GJETJEVE DHE PËRFUNDIMEVE PRELIMINARE

**Shkup, 14 prill 2014** – Kjo deklaratë e gjetjeve dhe përfundimeve preliminare është rezultat i përpjekjeve të përbashkëta të Zyrës së OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR) dhe Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (PACE).

Ambasadori Geert-Hinrich Ahrens nga Gjermania është Shef i MVZ i OSBE/ODIHR-it, i vendosur në vend që nga 10 marsi 2014. Stefan Schennach nga Austria e ka udhëhequr delegacionin nga PACE.

Vlerësimi e ka synuar përcaktimin nëse zgjedhjet janë në përputhshmëri me përkushtimet e OSBE-së dhe standardet e Këshillit të Evropës për zgjedhje demokratike, obligimet ndërkombëtare si dhe legjislacionin vendas. Deklarata e gjetjeve dhe përfundimeve preliminare jepet para përfundimit të procesit zgjedhor. Vlerësimi i përgjithshëm i zgjedhjeve do të varet pjesërisht edhe nga realizimi i fazave të mbetura të procesit zgjedhor, duke e përfshirë edhe numërimin, mbledhjen dhe shpalljen e rezultateve, si dhe trajtimin e kundërshtimeve dhe padive të mundshme pas ditës së zgjedhjeve. OSBE/ODIHR do ta publikojë raportin final gjithëpërfshirës me rekomandime për përmirësimet e mundshme, rreth tetë javë pas përfundimit të procesit zgjedhor.

---

### PËRFUNDIMET PRELIMINARE

---

Zgjedhjet presidenciale të 13 prillit 2014 janë administruar në mënyrë efikase dhe fushata ka qenë aktive. Procesi i regjistrimit të kandidatëve ka qenë përfshirës dhe kandidatët kanë pasur mundësi për ushtrim të lirë të fushatës. Ndonëse janë respektuar liritë themelore, raportimi i anshëm nga ana e mediave dhe mos ndarja e qartë e aktiviteteve shtetërore dhe atyre partiake nuk i ka siguruar kandidatëve mundësi të barabartë për pjesëmarrje në zgjedhje, që është në kundërshtim me paragrafin 5.4 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990 dhe standardet e Këshillit të Evropës.

Ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor i kanë trajtuar disa rekomandime paraprake të OSBE/ODIHR-it. Edhe pse nuk është praktikë e mirë të ndryshohen elementet themelore të kornizës ligjore brenda më pak se një viti para zgjedhjeve, ndryshimet e fundit janë miratuar me konsensus ndërpartiak dhe pas konsultimeve publike. Megjithatë, mbesin disa çështje të pavijueshmërisë dhe shqetësuese, përfshirë edhe kërkesën për dalje prej 40% në rrethin e dytë zgjedhor të zgjedhjeve presidenciale, që mund të rezultojë me cikle të zgjedhjeve të dështuara. Më tej, kërkesa e gjatë për të qenë banor për nominim si kandidat bie ndesh me përkushtimet e OSBE-së, standardet e Këshillit të Evropës dhe obligimet tjera ndërkombëtare.

Në përgjithësi, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) ka funksionuar në mënyrë efikase dhe shumica e mbledhjeve kanë qenë të hapura për vëzhguesit e akredituar dhe për mediat. Megjithatë, në raste të caktuara është vërejtur tension mes anëtarëve kur anëtarët kanë bërë intervenime të gjata politike dhe kanë votuar përgjatë linjave partiake për të gjitha çështjet kontestuese politike. Përveç kësaj, KSHZ nuk ka pasur komunikim efektiv me komisionet komunale zgjedhore (KKZ) për disa çështje, duke krijuar konfuzion mbi procedurat.

Për zgjedhjet janë regjistruar gjithsej 1.779.572 votues. Shumë bashkëbisedues e kanë ngritur çështjen e numrit të madh të votuesve të cilët jetojnë në adresën e njëjtë, ku nuk duket se banojnë. Krijimi i listës zgjedhore është problematik dhe i komplikuar si pasojë e përfshirjes së shumë agjencive me përgjegjësi të cilat përputhen, si dhe mungesës së bazës qendrore elektronike të të dhënave.

Zgjedhjet presidenciale janë mbajtur në sfond të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Parlamenti është shpërndarë pas mospajtit mes dy partive në koalicionin qeverisës mbi nominimin e kandidatit konsensual për president. Në zgjedhjet presidenciale, Presidenti në detyrë Gjorge Ivanov i cili garon për mandat të dytë, është sfiduar nga Stevo Pendarovski, Iljaz Halimi, kandidati i vetëm etnik shqiptar, si dhe nga Zoran Popovski.

Fushata ka qenë aktive dhe kandidatët kanë pasur agjenda të ngjeshura të tubimeve. Gjuha e përdorur nga kandidatët presidencialë ka qenë kryesisht e moderuar, por me afrimin e ditës së zgjedhjeve, është vërejtur rritje e retorikës negative ndërmjet udhëheqësve të Partisë Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE) nga njëra anë dhe partisë opozitare Lidhja Socialdemokrate të Maqedonisë (LSDM), në anën tjetër. Përveç kësaj, brenda bllokut etnik shqiptar janë shkëmbyer në mënyrë të vazhdueshme akuza të rënda për korrupsion në të kaluarën dhe kohën e sotme. Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI) ka bërë fushatë të njëkohshme me titull “Jo presidentit të njëanshëm”, duke i thirrur shqiptarët etnikë të përmbahen nga votimi për zgjedhjet presidenciale.

Kriteri i barazisë gjinore është respektuar në trupat e administrimit zgjedhor. Por, femrat nuk kanë qenë mjaft të përfaqësuara në tubimet e vëzhguara nga OSBE/ODIHR dhe çështjet gjinore nuk janë trajtuar në programet e kandidatëve. Të gjithë kandidatët presidencialë kanë qenë meshkuj.

Në aspektin e resurseve, përparësia domethënëse e presidentit në detyrë ka rezultuar me mbizotërim në billboardet dhe pllakatet e paguara. Përveç kësaj, tubimet e presidentit në detyrë janë dalluar dukshëm me praninë e Kryeministrit dhe ministrave tjerë. Përkrahja e qartë qeveritare për z. Ivanov gjatë fushatës ka kontribuar në mundësitë e pabarabarta për garë zgjedhore dhe nuk e ka respektuar në tërësi ndarjen mes shtetit dhe partisë, si që kërkohet sipas paragrafit 5.4 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990 dhe standardeve të Këshillit të Evropës.

Në përputhje me rekomandimet paraprake të OSBE/ODIHR, amendamentet e janarit 2014 lidhur me rregullat e financimit të fushatës kanë përcaktuar kufi të qartë për donacionet e personave juridikë, duke kërkuar nga pjesëmarrësit që të parashtrajnë raporte financiare një ditë para rrethit të dytë zgjedhor. Ndërkohë që legjislacioni i ri i financimit të fushatës ka qartësuar disa dispozita, megjithatë nuk siguron transparencë të plotë.

Ndonëse ka numër të madh të mediave, shumë bashkëbisedues të MNVZ-së kanë pohuar që partia qeverisëse ushtron kontroll indirekt mbi mediat, si pasojë e dominimit në tregun e reklamave. Më tej, mungesa e analizave politike dhe raportimit të pavarur ka qenë e përhapur gjerësisht. Dukuria e vetë-censurimit është vërejtur nga palët e përfshira në media. Dështimi i transmetuesit publik në raportimin e baraspeshuar dhe të barabartë e sfidon paragrafin 7.8 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990.

Mekanizmi për zgjidhjen e kontesteve zgjedhore është joefektiv. Më tej, mungesa e afateve për zgjidhjen e lëndëve zgjedhore ndikon në ndreqjen e hershme ligjore. Përveç kësaj, votuesit mund t'i sfidojnë vetëm vendimet për regjistrimin e votuesve dhe lëndimin e të drejtës së tyre votuese në ditën e zgjedhjeve. Këto mangësi nuk e kanë garantuar ndreqjen e plotë efektive, si që kërkohet me paragrafin 5.10 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990 dhe standardeve të Këshillit të Evropës.

Në ditën e zgjedhjeve, në një numër të kufizuar të vendvotimeve të vizituara nga MNVZ, administrata ka qenë e përgatitur mirë në aspektin procedural dhe procesi i votimit është administruar në mënyrë efikase. Por, në një komunë, procesi i votimit ka qenë problematik dhe janë shënuar numër më i madh i parregullsive. Votat janë numëruar në mënyrë profesionale dhe transparente. Prosesi i shpalljes së rezultateve ka qenë në përgjithësi i organizuar mirë, ndonëse ka pasur mospërputhje shumë të vogla në procesverbalet e rezultateve, që është përmirësuar nga këshillat komunalë zgjedhorë.

---

## GJETJET PRELIMINARE

---

### Konteksti

Në pajtim me dispozitat kushtetuese dhe ligjore, zgjedhjet presidenciale janë mbajtur më 13 prill, ndërsa rrethi i dytë i mundshëm është paraparë për 27 prill. Parlamenti është shpërndarë më 5 mars sipas nismës së Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), me çka janë përcaktuar për herë të tretë të njëpasnjëshme zgjedhje të parakohshme parlamentare për 27 prill, që përkon me rrethin e dytë të mundshëm të zgjedhjeve presidenciale. Ndonëse opozita e ka mbështetur nismën për zgjedhje të parakohshme, ata e kanë cilësuar këtë vendim si arsyetim i partive qeverisëse për thirrjen e zgjedhjeve, në periudhë kur hulumtimet e opinionit publik janë në favor të tyre për të fituar një mandat tjetër katërvjeçar.

Presidenti aktual Gjorge Ivanov, i ndërlidhur me VMRO-DPMNE-në garon për mandat të dytë. Në këto zgjedhje, ai është sfiduar nga Stevo Pendarovski, i ndërlidhur me Lidhjen Socialdemokrate të Maqedonisë (LSDM) në opozitë; Iljaz Halimi, kandidati i vetëm etnik shqiptar, i ndërlidhur me Partinë Demokratike Shqiptare (PDSH); si dhe nga Zoran Popovski, i ndërlidhur me Opsionin qytetar për Maqedoninë (GROM) që është themeluar para ca kohësh. BDI ka shpallur që do t'i bojkotojë zgjedhjet presidenciale, meqë partneri i saj i koalicionit VMRO-DPMNE i ka injoruar thirrjet e saj për propozimin e kandidatit konsensual, që do t'i përfaqësojë dy bashkësitë – maqedonasit etnikë dhe shqiptarët etnikë.<sup>1</sup>

### Korniza ligjore dhe sistemi zgjedhor

Zgjedhjet përcaktohen nga Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor, që është ndryshuar për here të fundit më 24 janar 2014 dhe i ka trajtuar disa rekomandime paraprake të OSBE/ODIHR.<sup>2</sup> Edhe pse nuk është praktikë e mirë të ndryshohen elementet themelore të kornizës ligjore brenda më pak se një viti para zgjedhjeve, ndryshimet e fundit janë miratuar me konsensus ndërpartiak.<sup>3</sup> Këto amendamente i përfshijnë masat mbrojtëse për ndarjen e partisë dhe shtetit; qartësimin e dispozitave për financimin e partisë dhe fushatës; të drejtën e partive politike për shikimin e listës zgjedhore dhe për të kërkuar ndryshime; afate për gjykatat për të vendosur mbi shkeljet e mediave, si dhe për përcjelljen e lëndëve në gjykata nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) dhe Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK).

Megjithatë, implementimi i legjislacionit ka zbuluar që disa çështje dhe pavijueshmëri edhe më tej mbesin pa trajtim. Këtu përfshihet kërkesa për dalje prej 40% në rrethin e dytë, që mund ta shkaktojë dështimin e zgjedhjeve presidenciale; procedura joefektive e ankesave; mungesa e qartësisë lidhur me fushatën para fillimit të saj; mungesa e afateve ligjore dhe mundësive për të parashtruar ankesa ndaj disa llojeve të kundërshtimeve zgjedhore, si dhe dispozitat restriktive për palët të cilat mund të parashtrjnë kundërshtime lidhur me zgjedhjet.

Presidenti zgjidhet në një njësi zgjedhore me votë të përgjithshme dhe të drejtpërdrejtë, përmes votimit të fshehtë për mandat pesëvjeçar, sipas sistemit të shumicës. Presidenti nuk mund të zgjidhet për këtë pozitë më tepër se dy herë. Për të qenë i zgjedhur në rrethin e parë, kandidati duhet të fitojë më tepër se 50% të numrit total të votuesve

---

<sup>1</sup> Lideri partiak, Ali Ahmeti, ka deklaruar më pas se do ta inkurajojnë bashkësinë etnike shqiptare të përmbahen nga votimi, për ta parandaluar përmbushjen e kërkesës për dalje prej 40% në rrethin e dytë, duke e shkaktuar dështimin e zgjedhjeve presidenciale. Përfaqësuesit e BDI-së i kanë përdorur nocionet “bojkot” dhe “përmbajtje nga votimi” me ndërkëmbim.

<sup>2</sup> Raportet paraprake të OSCE/ODIHR mund t'i gjeni në: <http://osce.org/odihr/elections/fyrom>

<sup>3</sup> Komisionit i Venedikut i Këshillit të Evropës, në Kodin e praktikës së mire të çështjeve zgjedhore, Paragrafi 2.2, rekomandon që “elementet thelbësore të ligjit zgjedhor, veçanërisht sistemi zgjedhor, anëtarësimi në komisionet zgjedhore dhe përcaktimi i kufijve të njësive zgjedhore, nuk duhet të ndryshohen në periudhë më të shkurtër se një vit para zgjedhjeve”. Për më tepër: <http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD%282002%29023-e>.

të regjistruar. Në të kundërtën, brenda dy javëve mbahet rrethi i dytë mes dy kandidatëve të cilët kanë marrë më së shumti vota në rrethin e parë. Në rrethin e dytë fiton kandidati që e fiton shumicën e votave, me kusht që dalja e votuesve të jetë mbi 40%. Përndryshe, përsëritet tërë procesi.<sup>4</sup>

### Administrimi zgjedhor

Zgjedhjet presidenciale janë administruar nga administrata zgjedhore në tre nivele: KSHZ, 80 komisionet komunale zgjedhore (KKZ), 3.480 këshillat zgjedhore (KZ) brenda vendit, si dhe 34 KZ në përfaqësitë diplomatike-konsullore (PDK). KSHZ përbëhet prej shtatë anëtarëve të emëruar nga parlamenti, me mandat katërvjeçar. Kryetari dhe dy anëtarë propozohen nga partitë opozitare, ndërsa zëvendëskryetari dhe tre anëtarë nga partitë qeverisëse.

Në përgjithësi, sesionet e KSHZ-së kanë qenë të hapura për vëzhguesit e akredituar dhe mediat, por ka pasur disa raste kur KSHZ nuk i ka ftuar ata të jenë të pranishëm.<sup>5</sup> KSHZ e ka respektuar shumicën e afateve ligjore dhe procesverbalet e sesioneve janë publikuar në ueb-faqen e KSHZ-së brenda 48 orëve, sipas rekomandimit paraprak të OSBE/ODIHR. Tensioni mes anëtarëve ka qenë i dukshëm në disa sesione të vijuar nga MVZ i OSBE/ODIHR, kur anëtarët shpesh herë kanë bërë intervenime të gjata politike dhe kanë votuar përgjatë linjave partiake për të gjitha çështjet e diskutueshme politike.

KKZ-të janë përgjegjëse për administrimin e zgjedhjeve në komunat gjegjëse. Ato përbëhen nga kryetari, katër anëtarë dhe zëvendësit e tyre, të përzgjedhur sipas zgjedhjes së rastit nga nëpunësit publikë, për mandat pesëvjeçar. KZ-të krijohen nga KKZ-të përmes modelit të përzier profesional-politik, ku një anëtar propozohet nga partitë politike qeverisëse, një nga partitë opozitare dhe tre anëtarë sipas zgjedhjes së rastit nga nëpunësit publikë. Kodi zgjedhor është ndryshuar me dispozitën ku kërkohet që kryetarët e KZ-ve të kenë diplomë universitare, ndërsa anëtarët të kenë arsim të mesëm. Sidoqoftë, MVZ i OSBE/ODIHR është informuar nga disa KKZ që kjo ka krijuar vështirësi gjatë identifikimit të numrit të nevojshëm të personave të kualifikuar.

Shumë KKZ janë ankuar për mungesë të komunikimit me KSHZ-në për çështje të ndryshme, që ka shkaktuar konfuzion lidhur me procedurat. Trajnimet e realizuara nga KSHZ për KKZ-të më 5 dhe 26 mars janë pranuar mirë. Video-incizimi i përgatitur me ndihmën e Misionit të OSBE-së në Shkup është përdorur për trajnimin e KZ-ve.<sup>6</sup> Janë respektuar dispozitat e Kodit zgjedhor për përfaqësim të barabartë etnik dhe gjinor në administratën zgjedhore.<sup>7</sup> Si që kërkohet nga ligji, KSHZ ka realizuar fushata për trajnimin e votuesve në mediat e shtypura dhe elektronike.

### Regjistrimi i votuesve

Në listën zgjedhore për votim në vend regjistrohen qytetarët me moshë të mbushur 18 vjeçare në ditën e zgjedhjeve, që kanë vendbanim në njësinë gjegjëse zgjedhore, kanë letërnjoftim ose pasaportë të vlefshme biometrike dhe të cilëve nuk ju është marrë aftësia e veprimit juridik me vendim gjyqësor. Për të votuar jashtë, votuesit duhet të regjistrohen në Ministrinë e Punëve të Brendshme si persona të cilët jetojnë ose punojnë përkohësisht jashtë vendit dhe duhet të regjistrohen në PDK-në gjegjëse. Ndonëse Kushtetuta nuk kërkon që

---

<sup>4</sup> Shikoni Mendimin e përbashkët të OSBE/ODIHR dhe Komisionit të Venedikut për Kodin Zgjedhor, ku ceket që “pragu aktual i 50% të votuesve të regjistruar (dhe jo votave të hedhura) për të fituar në zgjedhjet presidenciale në rrethin e parë mbetet disproporcional dhe mund të shkaktojë rreth të dytë edhe nëse vetëm një kandidat i fiton të gjithë tjerët me dallim të madh. Ruajtja e kriterit për dalje të votuesve në rrethin e dytë (ku kërkohet shumica e votave me prag prej 40% të votuesve të regjistruar) mund të shkaktojë cikle të zgjedhjeve të dështuara”. <http://www.osce.org/odihr/elections/102832>

<sup>5</sup> KSHZ ka mbajtur seancë të paparalajmëruar më 30 mars, kur janë refuzuar 639 paraqitje për votim jashtë vendit. Edhe sesionet nr. 79, 80, 81, 83 dhe 88 të KSHZ-së nuk janë paralajmëruar paraprakisht.

<sup>6</sup> Doracaku për KZ-të nuk ka qenë në dispozicion gjatë shumë trajnimeve për KZ-të dhe disa KKZ janë ankuar që është dashur t'i marrin doracakët nga KSHZ.

<sup>7</sup> Kriteri për përfaqësim proporcional dhe të barabartë etnik është bazuar në regjistrimin e fundit të vitit 2002.

personi të ketë vendbanim në vend për të qenë votues, Kodi Zgjedhor përcakton që vetëm qytetarët me vendbanim në vend mund të përfshihen në listën zgjedhore.

KSHZ i mban listat zgjedhore në bazë të informatave nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), e cila i lëshon letërnjoftimet dhe pasaportat biometrike. Ministria e Drejtësisë ia siguron informatat KSHZ-së për personat të cilët kanë ndërruar jetë. Pastaj, ndarja e listave zgjedhore sipas vendvotimeve bëhet nga Enti Shtetëror Statistikor (ESHS). Krijimi i listës zgjedhore është problematik dhe i komplikuar si pasojë e përfshirjes së shumë agjencive me përgjegjësi të cilat përputhen, si dhe mungesës së bazës qendrore elektronike të të dhënave.

Për votim në zgjedhjet presidenciale janë regjistruar 1.779.572 qytetarë. Gjatë periudhës së shikimit publik, rreth 73.400 persona e kanë kontrolluar regjistrimin e tyre në listën zgjedhore në zyrat rajonale të KSHZ-së, si dhe rreth 115.400 e kanë kryer kontrollimin përmes internetit. Gjithsej 8.332 prej rreth 70.000 qytetarëve me adresë në vend dhe që jetojnë ose punojnë përkohësisht jashtë vendit janë të regjistruar për votim jashtë vendit për zgjedhjet presidenciale.

Disa bashkëbisedues të MNVZ-së e kanë ngritur çështjen e numrit të madh të votuesve të cilët banojnë në një adresë, ku nuk duket se jetojnë. Kur është ngritur kjo çështje me Ministren e Brendshme, ajo ia ka konfirmuar MVZ të OSBE/ODIHR që ligji është i heshtur rreth çështjes nëse shumë njerëz mund të regjistrohen ligjërisht në një adresë.

### Regjistrimi i kandidatëve

E drejta për kandidaturë presidenciale i jepet të gjithë qytetarëve me të drejtë vote, të cilët kanë të paktën 40 vjet moshe dhe kanë jetuar në vend të paktën 10 vjet gjatë 15 viteve të fundit. Ndonëse është i pranueshme kriteri i kuptueshëm i banimit për përshtatshmërinë e kandidatit, kohëzgjatja prej 10 viteve është e tepërt dhe në disproporcion me parimet e barazisë, që i sfidon përkushtimet e OSBE-së, standardet e Këshillit të Evropës dhe obligimet ndërkombëtare.<sup>8</sup> Propozimi për president është dashur të mbështetet nga 10.000 votues ose 30 deputetë. Nënshkrimet për mbështetje është dashur të mblidhen para përfaqësuesve të KSHZ-së në ndonjërin prej zyrave rajonale të saj.

Regjistrimi i kandidatëve ka qenë përfshirës.<sup>9</sup> Prej gjashtë personave të nominuar, dy nuk i kanë mbledhur nënshkrimet e nevojshme, duke pohuar se obligimi për dhënien e nënshkrimeve para zyrtarit shtetëror ka qenë frikësues dhe numri i nënshkrimeve të nevojshme ka qenë shumë i lartë.<sup>10</sup>

### Fushata zgjedhore

Fushata ka filluar zyrtarisht më 24 mars dhe ka përfunduar në mesnatë më 11 prill. Fushata ka qenë aktive. Billbordet dhe pllakatet kanë dominuar në pjesën më të madhe të qyteteve, buzë rrugëve kryesore, ku ka mbizotëruar presidenti në detyrë. Edhe z. Pendarovski ka pasur dukshmëri të madhe në këtë fushatë. Fushatat e tyre më modeste, dy kandidatët tjerë pjesëmarrës në zgjedhje ia kanë përshkruar mungesës së mjeteve financiare. Kandidatët presidencialë kanë mbajtur edhe tubime të vogla dhe kanë bërë fushatë derë-më-derë, si mënyrë kryesore e komunikimit me votuesit. Të gjithë kandidatët i kanë shfrytëzuar mediat sociale dhe ueb-faqet si vegla kyçe për komunikim me votuesit.

---

<sup>8</sup> Paragrafi 24 i Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990 përcakton që kufizimet për të drejtat dhe liritë duhet të jenë “rreptësisht të proporcionale ndaj qëllimit të ligjit”. Më tej, paragrafi 15 i Komentit gjeneral nr. 25 të Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut (UNHCR) të vitit 1996 përcakton që “personat të cilët janë të përshtatshëm për kandidaturë zgjedhore nuk duhet të përjashtohen nga kërkesat e pakuptueshme ose diskriminuese, si që është arsimimi, banimi ose prejardhja, ose arsytet e përkatësisë politike”.

<sup>9</sup> Ndonëse të gjithë katër kandidatët presidencialë teknikisht janë regjistruar si kandidatë të pavarur, KSHZ e ka aprovuar shfrytëzimin e simboleve partiake për çdo kandidat në fletëvotim.

<sup>10</sup> Stojançe Angelov, Kryetari i *Dostoinstvo (Dinjiteti)* dhe Biljana Vankovska, kandidate e pavarur

Kandidatët janë përfshirë në programe të ngjeshura të tubimeve. MVZ i OSBE/ODIHR ka vëzhguar 79 tubime, ku kandidatët presidencialë, udhëheqësit partiakë dhe kandidatët për deputetë shpesh herë janë shfaqur së bashku. Ka qenë e dukshme që tubimet e z. Ivanov janë veçuar dukshëm me Kryeministrin dhe ministrat tjerë, që më vonë janë shpallur kandidatë për deputetë.<sup>11</sup> Mbështetja e qartë e qeverisë për kryetarin në detyrë gjatë fushatës nuk e ka respektuar në masë të plotë ndarjen e partisë nga shteti, si që kërkohet sipas paragrafit 5.4 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990.<sup>12</sup> Me përjashtim të z. Pendarovski, të gjithë kandidatët kanë bërë fushatë me udhëheqësit e ndërlidhur partiak. Tubimet kanë vijuar pa pengesa<sup>13</sup> dhe në përgjithësi kanë pasur përcjellje të mirë, ndonëse meshkujt kanë dominuar.<sup>14</sup> Sidoqoftë, janë raportuar në polici disa incidente të shkatërrimit të shtabeve partiake zgjedhore dhe të materialit të fushatës.<sup>15</sup>

Çështjet e interesimit të përbashkët, të pasqyruara në programet e të gjithë kandidatëve e kanë përfshirë zhvillimin ekonomik, varfërinë dhe papunësinë, emigracionin e të rinjve, zgjidhjen e çështjes së emrit, si dhe integrimin në Bashkimin Evropian (BE) dhe Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO). Z. Pendarovski dhe z. Popovski kanë bërë fushatë të dukshme për dëshirën e tyre për t'i dhënë fund politikës së ndarjes, të cilën e shohin si diçka që e shtur shtetin. BDI ka bërë fushatë të njëkohshme me titull “Jo presidentit të njëanshëm”, për ta promovuar qëllimin e saj për zgjedhjen e presidentit konsensual në parlament. Partia i ka bërë thirrje shqiptarëve etnikë të përmbahen nga votimi për zgjedhjet presidenciale.<sup>16</sup>

Ndërsa të gjithë katër kandidatët presidencialë kanë proklamuar se do t'i përfaqësojnë të gjithë qytetarët e vendit nëse fitojnë, kandidatët kryesisht i kanë pasur në shënjestër votuesit e bashkësive të tyre etnike. Megjithatë, z. Pendarovski është angazhuar në përafrimin ndaj bashkësisë etnike shqiptare, duke folur pak shqip dhe duke i shfaqur materialet e promovimit zgjedhor edhe në gjuhën shqipe, gjatë ngjarjeve në zonat etnike shqiptare. Bashkësia rome ka qenë aktive dhe e dukshme gjatë fushatës, veçanërisht në tubimet për VMRO-DPMNE-në.

Gjuha e përdorur në fushatën e kandidatëve presidencialë ka qenë kryesisht e qytetëruar dhe moderuar, por me afrimin e ditës së zgjedhjeve, është vërejtur rritje e retorikës negative ndërmjet kandidatëve të lidhur me VMRO-DPMNE-në dhe LSDM-në.<sup>17</sup> Përveç kësaj, në mënyrë të vazhdueshme janë shkëmbyer akuza të rënda për korrupsion në të kaluarën dhe kohën e sotme, ndërmjet kundërshtarëve politikë brenda blloqeve etnike. PDSH dhe BDI janë sulmuar mes vete për vendimin për të garuar me kandidat, gjegjësisht për bojkotimin e zgjedhjeve presidenciale. Fjalimet në tubimet e PDSH-së gjithmonë e më tepër kanë pasur gjuhë nxitëse për BDI-në,

<sup>11</sup> Prej 15 tubimeve për z. Ivanov para fillimit zyrtar të fushatës parlamentare më 5 prill, ministrat kanë qenë të pranishëm në 13 prej tyre.

<sup>12</sup> Paragrafi 5.4 i Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990 e përcakton “ndarjen e qartë mes Shtetit dhe partive politike. Në veçanti, partitë politike nuk mund të mishërohet me Shtetin”. Shikoni edhe paragrafin I.3.1 të Kodit të Komisionit të Venedikut për praktikën e mirë.

<sup>13</sup> Përjashtimi e përfshin tubimin për z. Pendarovskin, që është planifikuar për 29 mars në Shuto Orizarë, por që është anuluar meqë partia ka marrë informata që një grup i organizuar (për të cilët pretendohet se janë anëtarë të partisë që është pjesë e koalicionit qeverisës), ka dashur të provokojë incidente.

<sup>14</sup> Niveli mesatar i pjesëmarrjes së femrave në tubimet e vëzhguara nga vëzhguesit afatgjatë të OSBE/ODIHR-it ka qenë 25%, me përfaqësim dukshëm më të ulët në ngjarjet e fushatave të PDSH-së dhe BDI-së.

<sup>15</sup> Më 1 prill, tre zyra të LSDM-së në Prilep janë vandalizuar me grafitë, përfshirë edhe shenjën svastike. Më 7 prill janë shkatërruar pllakatet në zyrën e LSDM-së në Makedonska Kamenica dhe janë zëvendësuar me pllakate të z. Ivanov. Më 7 prill është vandalizuar zyra e LSDM-së në Negotinë, ndërsa më 8 prill është dëmtuar shtabi zgjedhor i GROM-it në Karposh.

<sup>16</sup> Edhe ngjarjet e fushatës së BDI-së janë veçuar me praninë e ministrave dhe kandidatëve për deputetë. Dy organizata joqeveritare vendase, “Zgjuhu” (me seli në Shkup) dhe “Tradita” (me seli në Tetovë) kanë bërë fushatë ndaras duke i bërë thirrje shqiptarëve etnikë për bojkotimin e zgjedhjeve presidenciale.

<sup>17</sup> Për shembull, në tubimin më 26 mars në Kavadar, z. Pendarovski deklaroi që z. Ivanov është nën kontrollin e kryeministrit. Në një tubim për z. Ivanov më 2 prill në Berovë, z. Pendarovski është akuzuar nga disa folës të VMRO-DPMNE-së që e ka ndihmuar mashtrimi zgjedhor në vitin 2004, që e ka sjellë Cërvenkovskin në pozitën presidenciale.

veçanërisht për liderin e saj, Ali Ahmeti.<sup>18</sup> PDSH e ka akuzuar BDI-në edhe për rrezikimin e fshehtësisë së votës shqiptare përmes thirrjes për bojkot – veçanërisht në fshatrat e vogla.

Gjatë fushatës kanë vazhduar pohimet për frikësimin e votuesve dhe keqpërdorimin e resurseve shtetërore. Vëzhguesit afatgjatë të MVZ të OSBE/ODIHR kanë pranuar disa pohime të besueshme për presion, të ushtruar veçanërisht mbi nëpunësit e sektorit publik, ku përfshihet presioni për pjesëmarrje në ngjarjet e fushatës (ndonjë herë edhe gjatë orarit të punës), presioni për të mos marrë pjesë në ngjarjet e kundërshtarëve, premtimet ose kërcënimet për punësim në institucionet shtetërore, nxitjet për vota përmes mjeteve si ndihma sociale, si dhe aktivistët partiakë të cilët kërkojnë nga nëpunësit publikë të sigurojnë listë të votuesve të identifikuar, të cilët do të votojnë për partinë qeverisëse.

### Financimi i fushatës

Korniza ligjore me të cilën rregullohet financimi i fushatës është ndryshuar në janar 2014, për t'i trajtuar disa prej rekomandimeve paraprake të OSBE/ODIHR-it, përfshirë edhe limitin e qartë për donacionet nga personat juridikë, si dhe kërkesa nga pjesëmarrësit në garën zgjedhore për parashtrim të raportit financiar një ditë para rrethit të dytë.<sup>19</sup>

Raporti i parë financiar për zgjedhjet presidenciale është dorëzuar më 3 prill dhe është publikuar me kohë. Z. Ivanov ka paraqitur gjithsej të hyra 14.306.396 MKD nga 595 donatorë fizikë, si dhe 31.149.203 MKD shpenzime. Z. Pendarovski ka paraqitur gjithsej të hyra 6.129.211 MKD nga donatorë fizikë dhe burime tjera, si dhe 5.663.790 MKD shpenzime. Z. Popovski ka paraqitur gjithsej të hyra 500.000 MKD nga 9 donatorë dhe nivel të barabartë të shpenzimeve.<sup>20</sup> Z. Halimi ka deklaruar zero të hyra dhe zero shpenzime. Ligji nuk e përcakton revizionin e raporteve financiare para-zgjedhore dhe nuk parasheh sanksione për mos parashtrimin e tyre, që e ul integritetin dhe transparencën e procesit.

Përkitazi me praktikën e mirë, raportet finale të financimit të fushatës duhet të parashtrohen brenda 30 ditëve nga dita e votimit dhe ESHR i shqyrton ato brenda 60 ditëve nga dita e parashtrimit.<sup>21</sup> Në rastet kur ESHR vëren parregullsi, mund të kërkojë nga KSHZ ta suspendojë kompensimin në masë të plotë ose pjesërisht. ESHR mund të iniciojë edhe procedurë të kundërvajtjes ose ta paraqesë rastin në prokurori, brenda 30 ditëve nga dita e identifikimit të parregullsisë, ndonëse nuk ka afate brenda të cilave duhet të vendosin gjykatat.

### Mediat

Ndonëse ka numër të madh të mediave të cilat funksionojnë në vend, shumë bashkëbisedues të MNVZ kanë pohuar që mediat më të spikatura janë nën kontroll indirekt nga partia qeverisëse, meqë qeveria është reklamuesi më i madh i vetëm. Më tej, mungesa e analizave politike dhe raportimit të pavarur ka qenë e përhapur gjerësisht. Palët e përfshira me mediat e kanë cekur dukurinë e vetë-censurimit. Monitorimi i mediave që është realizuar nga MVZ i OSBE/ODIHR ka treguar anësim të qartë në favor të koalicionit qeverisës VMRO-DPMNE dhe kandidatit

<sup>18</sup> Më 3 prill në Bogovinë dhe më 4 prill në Tetovë, folësit në tubimet e PDSH-së i kanë cekur “problemet psikologjike” dhe “korrupsionin familjar” të Ahmetit, duke pohuar se anëtarët e BDI-së, përfshirë edhe z. Ahmeti kanë orkestruar krime dhe dhunë kundër shqiptarëve etnikë (janë treguar edhe fotografi).

<sup>19</sup> Garuesi zgjedhor nuk mund të shpenzojë më tepër se 180 MKD për çdo votues të regjistruar. Garuesit kompensohen për shpenzimet zgjedhore nga buxheti shtetëror, me nga 15 MKD për çdo votë të fituar, nëse kanë marrë më tepër se 1.5% nga numri i përgjithshëm i totalit të votave të hedhura. Personat fizikë mund të japin donacion deri në 5.000 EUR në kundërvlerë, ndërsa personat juridikë deri në 50.000 EUR. Ndalohen donacionet anonime, si dhe nga burimet shtetërore, publike, komunale ose të huaja, nga shoqatat e qytetarëve dhe bashkësitë fetare.

<sup>20</sup> 1 EUR vlen 61 MKD.

<sup>21</sup> Paragrafi 200 i Udhëzimeve të OSBE/ODIHR dhe Komisionit të Venedikut për rregullat mbi partitë politike përcakton që “raportet e financimit të fushatës duhet t'i dorëzohen autoriteteve përgjegjëse brenda jo më shumë se 30 ditëve nga dita e zgjedhjeve (...) Duke u synuar mbështetjen e transparencës, është praktikë e mirë që këto raporte financiare të publikohen në internet me kohë”. Shikoni <http://www.osce.org/odihr/77812?download=true>.

Ivanov, duke qenë qartazi kundër LSDM-së dhe kandidatit të saj, si që është vërejtur në shumicën e transmetuesve nën monitorim.

Kodi zgjedhor i obligon mediat e transmetuara ta mbulojnë fushatën në mënyrë të drejtë, të baraspeshuar dhe të paanshme. Ceken edhe kërkesat e detajuara për edicionet informative të transmetuesit publik, Radiotelevizionit Maqedonas (RTM) gjatë fushatës zgjedhore: një e treta e edicionit informativ duhet t'i përkushtohet ngjarjeve lokale dhe ndërkombëtare, një e treta për aktivitetet e partive politike qeverisëse, ndërsa një e treta për aktivitetet e partive në opozitë.<sup>22</sup> Sipas dispozitës së cekur, kandidatët të cilët nuk mbështeten nga partitë parlamentare nuk kanë të drejtë për përfshirje në raportim gjatë edicioneve informative. Mos-sigurimi i raportimit të baraspeshuar dhe të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit, nga ana e transmetuesit publik, e sfidon paragrafin 7.8 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990.<sup>23</sup>

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (ASHMAA) i ka miratuar “Specifikat e metodologjisë për monitorimin e procesit zgjedhor 2014”, ku mes tjerash i rekomandohet TVM-së që të përcaktojë kohë shtesë në edicionet informative për kandidatët të cilët nuk mbështeten nga asnjë parti parlamentare. Ndonëse pa peshë të obligimit juridik, ky dokument i qartëson kërkesat ligjore për raportimin e mediave mbi fushatën. Gjatë fushatës, ASHMAA ka marrë 60 ankesa nga LSDM, të cilat i ka hedhur poshtë, shumica prej të cilave kanë pohuar se raportimi për zyrtarët shtetërorë është fushatë dhe që janë publikuar hulumtimet e mendimit publik pa i siguruar të gjitha të dhënat e kërkuara nga ligji. Përveç kësaj, ASHMAA ka iniciuar 12 procedura të kundërvajtjes kundër 8 transmetuesve, kryesisht për shkeljen e rregullave të reklamimit të paguar politik.

Rezultatet e monitorimit të mediave nga OSBE/ODIHR tregojnë që ndonëse raportimi sasior i garuesve zgjedhorë në edicionet informative ka qenë në pajtim me dispozitat ligjore, ka pasur dallim në tonin e raportimit: fushata e presidentit në detyrë është raportuar me ton pozitiv në *RTM-1* dhe *RTM-2*, ndërsa raportimi për tre kandidatët tjerë ka qenë kryesisht neutral.<sup>24</sup> Përveç kësaj, *RTM-2* i ka kushtuar raportim të gjerë aktivitetëve të BDI-së dhe fushatës së tyre me të cilën thirren shqiptarët etnikë të përbahen nga votimi në zgjedhjet presidenciale.

Prej kohës së raportimit për garuesit presidencialë në edicionet informative, televizioni privat *Sitel* i ka kushtuar 47% dhe *Kanal 5* i ka kushtuar 40% kandidatit në detyrë, ndërsa *TV Alfa* i ka kushtuar 36% z. Ivanov dhe 38% z. Pendarovski. Por, ndërkohë që toni i raportimit për z. Ivanov ka qenë kryesisht pozitiv ose neutral, raportimi për z. Pendarovski ka qenë më tepër negativ. Monitorimi i mediave ka identifikuar edhe disa kronika të transmetuara nga këto tre stacione, të cilat kanë qenë shumë të ngjashme sipas përmbajtjes, duke iu referuar burimeve të paidentifikuara ose anonime dhe kanë qenë të anshme kundër LSDM-së. *TV Telma*, *Vesti 24* dhe *Alsat-M* kanë pasur raportim më të baraspeshuar të fushatës në edicionet informative dhe i kanë kushtuar proporcione të ngjashme të raportimit kryesisht neutral z. Ivanov dhe z. Pendarovski.

Transmetuesit privatë kanë të drejtë të shesin deri në 12 minuta në orë për reklama të paguara politike, ku maksimumi për një garues zgjedhor është 8 minuta brenda një ore. Monitorimi i reklamimit politik nga MVZ i OSBE/ODIHR ka treguar që mbi 23 orë të reklamimit të cekur e kanë promovuar z. Ivanov, mbi 7 orë është promovuar z. Popovski, ndërsa vetëm 3 orë kanë qenë në favor të z. Pendarovski.<sup>25</sup>

<sup>22</sup> Hapësira kohore duhet t'i jepet partive qeverisëse dhe opozitare varësisht nga rezultatet e zgjedhjeve të fundit parlamentare.

<sup>23</sup> Paragrafi 7.8 i Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990 përcakton që “asnjë pengesë administrative ose ligjore nuk duhet ta pengojë qasjen e papenguar ndaj mediave, pa diskriminim për grupet politike dhe individët të cilët kanë dëshirë të marrin pjesë në procesin zgjedhor”.

<sup>24</sup> Mediat e monitoruara: *RTM-1*, *RTM-2*, *Sitel*, *Kanal 5*, *Alsat-M*, *Telma*, *Alfa* dhe *Vesti 24*. Gazetat: *Dnevnik*, *Nova Makedonija*, *Sloboden Pecat* dhe *Koha*. MVZ i OSBE/ODIHR e ka monitoruar raportimin në kohën me shikueshmëri më të lartë (18:00-24:00) të shtatë stacioneve televizive gjatë fushatës. Sa i përket *Vesti 24*, është monitoruar vetëm edicioni kryesor i ditërit (20:00).

<sup>25</sup> LSDM i ka cekur MVZ të OSBE/ODIHR që partia ka tentuar të blejë më tepër kohë në TV *Sitel* dhe *Kanal 5*, por janë informuar që pjesa më e madhe e kohës është blerë nga garuesit tjerë.



Gjatë fushatës ka pasur shumë mundësi të kufizuara për ballafaqim me z. Ivanov. Është organizuar vetëm një debat me të gjithë katër kandidatët në RTM-1. Pas debatit, transmetuesi publik ka organizuar diskutim, që është fokusuar kryesisht në dështimet e perceptuara të z. Pendarovskit.

### Kundërshtimet dhe paditë

Kundërshtimet që kanë të bëjnë me zgjedhjet shqyrtohen nga KSHZ, gjykatat themelore, gjykatat e apelit, si dhe Gjykata Administrative. Kodi Zgjedhor ia jep të drejtën të gjithë kandidatëve të parashtrojnë kundërshtime në fazat e ndryshme të procesit, përfshirë edhe për regjistrimin e votuesve, regjistrimin e kandidatëve, parregullsitë e lidhura me fushatën dhe mediat, numërimin dhe shpalljen e rezultateve. Ndërkohë, votuesit kanë të drejtë të parashtrojnë kundërshtime vetëm për regjistrimin e votuesit dhe kur shkelen të drejtat e tyre në ditën e zgjedhjeve. Më tej, nuk mund të parashtrohet ankesë ndaj disa vendimeve të trupave administrativë.<sup>26</sup> Në përgjithësi, kjo nuk e garanton ndreqjen e plotë efektive, si që përcaktohet me paragrafin 5.10 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990.<sup>27</sup>

Në KSHZ janë parashtruar tetë kundërshtime lidhur me aktivitetet e fushatës që janë realizuar para fillimit zyrtar të fushatës.<sup>28</sup> Në njërin rast, KSHZ e ka pranuar kundërshtimin e LSDM-së, ku është pretenduar që z. Ivanov është angazhuar në fushatë të parakohshme më 14 mars, ditën kur është konfirmuar si kandidat presidencial; KSHZ ka ngritur procedurë të kundërvajtjes. Tjerat janë refuzuar me arsyetimin se ata të cilët kanë bërë fushatë ende nuk kanë qenë kandidatë të konfirmuar. Më tej, janë parashtruar dy kundërshtime në KSHZ nga BDI dhe LSDM sipas dispozitës së re të Kodit Zgjedhor, ku partive politike i lejohet kundërshtimi i listës zgjedhore, pas përfundimit të periudhës së shikimit publik.<sup>29</sup> KSHZ ka kërkuar nga MPB që t'i hetojë kundërshtimet, por ajo ka refuzuar, duke cekur se e ka përmbyshur detyrën ligjore. Më pas, KSHZ i ka refuzuar kërkesat, duke votuar përgjatë linjave partiake. LSDM dhe BDI kanë parashtruar padi ndaj vendimit në Gjykatën Administrative, e cila i ka refuzuar ato në bazë të dokumenteve të siguruar nga MPB, pa realizuar hetim të pavarur.

KSHZ, ESHR dhe KSHPK nuk mund të shqiptojnë sanksione, por mund t'ia përcjellin lëndët gjykatave kompetente, duke iniciuar procedura penale ose për kundërvajtje. Nuk ka afate për përfundimin e rasteve të këtilla, që e ngrit pyetjen e ndreqjes së hershme dhe efektive brenda kornizës zgjedhore.

### Vëzhguesit qytetarë dhe ndërkombëtarë

Kodi zgjedhor e mundëson vëzhgimin e zgjedhjeve nga vëzhguesit qytetarë dhe ndërkombëtarë, si dhe përfaqësuesit e autorizuar të kandidatëve, në të gjitha nivelet e administrimit zgjedhor. Në KSHZ janë regjistruar gjithsej 326 vëzhgues ndërkombëtarë, përfshirë edhe ambasadat e përfaqësuara në vend. Grupi i vëzhguesve qytetarë me numër më të madh të vëzhguesve ka qenë Asociacioni për aktivitete humanitare SINERGIJA me 4.970 vëzhgues, MOST me 1790 vëzhgues, Asociacioni i qytetarëve për demokratizim dhe ngritje të vetëdijes publike VEPRO nga Struga me 1.500 vëzhgues, si dhe CIVIL me 50 vëzhgues. Përkitazi me rekomandimin e

<sup>26</sup> Për shembull, kundërshtimet kundër vendimeve të KSHZ-së për shkeljen e kohës dhe formës së fushatës, sipas Nenit 69-a të Kodit Zgjedhor; kundërshtimet kundër vendimeve të KSHPK-së për keqpërdorimin e resurseve shtetërore, sipas Nenit 74 të Kodit Zgjedhor, si dhe paditë kundër vendimeve të ESHR-së dhe KSHPK-së lidhur me shkeljet e financimit të fushatës, sipas Nenit 177-a të Kodit Zgjedhor.

<sup>27</sup> Paragrafi 5.10 i Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990 përcakton që “të gjithë duhet të kenë të drejtë të mjeteve efektive të ndreqjes kundër vendimeve administrative, për ta garantuar respektimin e të drejtave themelore dhe për ta siguruar integritetin ligjor”. Shikoni edhe paragrafin II.3.3 të Kodit të Komisionit të Venedikut për praktikën e mirë në çështjet zgjedhore.

<sup>28</sup> Tre janë parashtruar nga LSDM, një nga Aleanca për Maqedoni Pozitive (AMP) kundër VMRO-DPMNE-së. Katër janë parashtruar nga VMRO-DPMNE kundër LSDM-së.

<sup>29</sup> BDI e ka kërkuar shlyerjen e 453 qytetarëve – të gjithë të regjistruar për votim në Ambasadën në Tiranë. LSDM ka kundërshtuar 14,492 emra, duke pohuar që grupe njerëzish janë regjistruar ilegalisht në adresa të njëjta, 991 njerëz të vdekur, si dhe tjerë të cilët kanë ndërruar adresë ose janë larguar nga vendi.

kaluar të OSBE/ODIHR, të gjithë vëzhguesit kanë të drejtë të marrin kopje të procesverbaleve të rezultateve nga KKZ-të dhe KZ-të.

### Dita e zgjedhjeve

Votimi i hershëm më 12 prill, i vëzhguar nga MVZ i OSBE/ODIHR, është realizuar mirë në përgjithësi; janë respektuar procedurat dhe votimi ka rrjedhur në mënyrë të qetë dhe me rregull. Sa i përket votuesve që kanë votuar në shtëpi, disa KKZ e kanë shprehur shqetësimin e tyre lidhur me kërkesat më të rrepta të përshtatshmërisë të përcaktuara nga vendimi i KSHZ-së, që ka rezultuar me disa aplikacionet të refuzuara nga KKZ-të. Gjatë votimit në burgje, MVZ i OSBE/ODIHR ka vërejtur disa raste kur të burgosurve me letërnjoftime të vlefshme ju është refuzuar e drejta e votimit, meqë nuk kanë qenë të përfshirë në listën e votuesve.

Në ditën e zgjedhjeve, në një numër të kufizuar të vendvotimeve të vizituara nga MNVZ, administrata ka qenë e përgatitur mirë në aspektin procedural dhe procesi i votimit është administruar në mënyrë efikase, por në një komunë, procesi i votimit ka qenë problematik dhe janë shënuar numër më i madh i parregullsisë.<sup>30</sup> Votat janë numëruar në mënyrë profesionale dhe transparente. Prosesi i shpalljes së rezultateve ka qenë në përgjithësi i organizuar mirë, në disa KKZ që janë vizituar. Ndonëse ka pasur mospërputhje shumë të vogla në procesverbalet e rezultateve të KZ-ve, këto gabime teknike janë përmirësuar nga KKZ-të. Dalja e raportuar ka qenë 48%, por pjesëmarrja e votuesve ka mbetur e ulët në rajonet etnike shqiptare. Shumica e bashkëbiseduesve të MNVZ-së ia kanë përshkruar këtë gjendje presionit të BDI-së të ushtruar mbi votuesit etnikë shqiptarë.

*Versioni në gjuhën angleze i këtij raporti është dokumenti i vetëm zyrtar.  
Sigurohen përkthime jozyrtare në gjuhën shqipe dhe maqedonase.*

---

## INFORMATATA PËR MISIONIN DHE MIRËNJOHJE

---

**Shkup, 14 prill 2014** – MVZ i OSBE/ODIHR u hap në Shkup më 10 mars me 11 ekspertë në kryeqytet dhe 20 vëzhgues afatgjatë të shpërndarë në mbarë vendin.

Vëzhguesit kanë vizituar numër të kufizuar të vendvotimeve në mbarë vendin në ditën e zgjedhjeve, ndonëse vëzhgimi nuk është realizuar në mënyrë gjithëpërfshirëse. Në ditën e zgjedhjeve janë shpërndarë 42 vëzhgues, përfshirë edhe 15 vëzhgues parlamentarë nga PACE, si dhe 27 vëzhgues afatgjatë dhe ekspertë nga OSBE/ODIHR. Gjithsej ka pasur vëzhgues nga 23 shtete-pjesëmarrëse të OSBE-së. Për shkak të mungesës së delegimit të vëzhguesve afatshkurtër, OSBE/ODIHR nuk ka pasur mundësi të realizojë vëzhgim të gjerë dhe sistematik të veprimeve në ditën e votimit të zgjedhjeve presidenciale më 13 prill, përmes shpërndarjes së vëzhguesve afatshkurtër.

Institucionet e përfaqësuara dëshirojnë t'i falënderojnë autoritetet për ftesën për vëzhgimin e zgjedhjeve, Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve për bashkëpunimin dhe sigurimin e dokumenteve për akreditim, Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe organet tjera për ndihmën dhe bashkëpunimin e tyre. MNVZ- i OSBE/ODIHR e falënderon edhe Misionin e OSBE-së në Shkup dhe institucionet tjera ndërkombëtare për bashkëpunimin dhe përkrahjen e tyre.

---

<sup>30</sup> Është raportuar për një grindje mes ish-deputetes Radmila Shekerinska (nënkryetare e LSDM-së) dhe ish-deputetit Amdi Bajram (Kryetar i Lidhjes së Romëve të Maqedonisë), që po hetohet nga policia.

**Për informata plotësuese, ju lutemi kontaktoni:**

- Ambasadorin Geert-Hinrich Ahrens, Shef i MVZ i OSBE/ODIHR në Shkup, (+389 (0)2 3121 657);
- Z. Thomas Rymer, Zëdhënës i OSBE/ODIHR, (+389 72 209 788 dhe +48 609 522 266) ose znj. Tamara Otiashvili, Këshilltare për Zgjedhje në OSBE/ODIHR në Varshavë (389 77 553 814 ose +48 22 5200 680).
- Seksioni i komunikimit në PACE (+33 88 413 193)

**Adresa e MVZ të OSBE/ODIHR**

Bul. Ilinden, nr.76, 1000 Shkup

Tel: +389 (0)2 3121 657, Faksi: +389 (0)2 3119 524, E-mail: [office@odihr.org.mk](mailto:office@odihr.org.mk)

Ueb-faqja: <http://www.osce.org/odihr/elections/116272>